

## “ TË PRAKTIKOJME SË BASHKU ANGLISHTEN”

Në dt. 19-20 Prill 2017, në Fakultetin e Shkencave të Natyrës dhe Shkencave Humane si dhe në Fakultetin e Edukimit e Filologjisë, në Universitetin “Fan S. Noli” u zhvillua veprimtaria e titulluar “ Let’s practice English together” - “ Të praktikojmë së bashku Anglishten”. Kjo veprimtari u organizua dhe u mbështet nga Këshilli i Studentëve të këtij Universiteti, Qendra e Karrierës dhe Alumni. Përshëndetën veprimtarinë Rektori i Universitetit Prof. dr. Ali Jashari si edhe Dekani i Fakultetit të Shkencave të Natyrës dhe Shkencave Humane Prof. dr. Gjergji Pendavinji. Qëllimi i veprimtarisë ishte të promovonte gjuhën angleze dhe t’i motivonte studentët për mësimin e kësaj gjuhe me rëndësi globale. Studentë, pedagogë si dhe miq të huaj që jetojnë në qytetin e Korçës, sollën përvojën e tyre personale në mësimin e gjuhëve të huaja.

